



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.02.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 25.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të dytë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/22 Nr. i faq./Br.str/No.pg 76

Data/Datum/Date 28.02.2025

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” në kategorinë: Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale, 01 Nr. 80/20 e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21, të datës 26.2.2021 dhe Rregulloren 01 Nr. 22/23 të datës 28.2.2023;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit 01-Nr. 280/24 të datës 26.12.2024;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot.01 Nr. 181/24 i datës 30.01.2024, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit;
7. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, 2024/2025;

Shtesë: Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Pika shtesë ka të bëjë me kërkesë të disa bizneseve në rrugën Rahovec - Suharekë, që ka ardhur javën e kaluar. Kërkojmë mirëkuptimin e juaj, për shkak të arsyeshmërisë sipas kushteve dhe kërkesave të paraqitura nga KEDS-i, duhet t'i japim pëlqim dhe të ndajmë një lokacion në këtë pronë të komunës, në sipërfaqe prej 2m² për vendosjen e trafos elektrike.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, kolegë, monitorues, të gjithë të pranishëm. Drejtor, te vendimi e pata një pyetje, kuvendi komunal - Drejtoria e Rrugëve? A kemi drejtor të rrugëve? Apo ka të bëjë me drejtorinë e rrugëve në Ministrinë e Infrastrukturës – Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve. A ka nevojë për përmirësim?

Afrim Oruqi: Ka ende prona komunale që emërtohet, Komuna e Rahovecit – Prona shoqërore, prona publike publike te Drejtoria e Rrugëve. Është një vendim për unifikim të vendimeve, deri në zbatimin e këtij vendimi prej Agjencionit

Kadastral të Kosovës, e kemi paraqitur ashtu siç është në çertifikatë. Do të duhen muaj të tërë për përmirësim. Ne vazhdojmë ashtu siç është në çertifikatë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk keni edhe diçka tjetër, pikën shtesë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht, (25) votohet pika shtesë. Të nderuar anëtarë, tani e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht, (25) votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht, (25) votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë, pjesëmarrës. Duke u bazuar në kërkesën e KPF-së, për informata rreth kushteve ndërtimore për lëndën e z. Hamdi Cena. Informata është gati dhe ju kam përcjellur përmes zyrës së kuvendit në e-mailin tuaj. Dua të theksoj në parim thelbësor se Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, punon në bazë të planeve që janë të miratuara në këtë kuvend dhe ligjeve që janë në fuqi. Asnjë vendim nuk merret jashtë kornizës ligjore. Kjo nuk është çështje dëshirash, por obligim ligjor dhe përgjegjësi institucionale ndaj komunitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Lënda e z. Hamdi Cena për kushte ndërtimore në Drejtori të Urbanizmit ka ardhur më datë 05.07.2024 me numër të protokollit 200. Lënda është trajtuar nga zyrtarët e drejtorisë dhe më 12.07.2024, palës i është dërguar njoftimi që mund të paraqes projektin në pjesën që është brenda zonës ndërtimore, sipas PZhK-së 2023-2031, Planit Urban, vendimit mbi ndryshim-plotësimin, vendimit mbi zgjerimin e kufirit ndërtimor, Planit Gjeneral Urbanistik dhe ligjeve që janë në fuqi. Drejtoria për Urbanizëm i dërgon njoftim palës dhe i kërkon që brenda kufijve ndërtimor të sjellë projektin për pjesën që është brenda zonës ndërtimore. Pala nuk i është përgjigjur këtij njoftimi dhe nuk e ka sjellur fare projektin. Kërkesa është hedhur poshtë, sepse nuk mund të lëshohen kushtet ndërtimore që janë në kundërshtim me PZhK-në dhe ligjet në fuqi. Pala, pas marrjes së vendimit të drejtorisë ka bërë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Të gjitha ankesat që më parë kanë shkuar në ministri, të gjitha janë bërë përmes drejtorisë, por në këtë rast ankesa ka shkuar direkt në ministri. Ministria ka nxjerr vendim pa marrë dokumente shtesë dhe pa u konsultuar me Drejtorinë për Urbanizëm. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ne Nr.prot 5556-2/24 më 24.10.2024 ka nxjerrë vendimin, ku thotë: E bazuar ankesa e Hamdi Cenës dhe obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit, të rivendosë në pjesën e palës konform ligjit 04L-110 për ndërtimin, udhëzimet administrative në fuqi dhe të nxjerrë aktin administrativ. Në bazë të vendimit të ministrisë, Drejtoria për Urbanizëm më datë 12.11.2024, njofton palën se duke u bazuar në vendimin e ministrisë, kërkesa e palës duhet të rivendoset në përputhje me ligjin për ndërtim, udhëzimet administrative në fuqi dhe do të nxjerret akti administrativ. Me njoftimin e datës 12.11.2024, Drejtoria për Urbanizëm njofton palën se, për pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 8400m², e cila sipas PZhK-së përfshihet në zonën ndërtimore dhe që mund të pajiset me kushte ndërtimore. Prandaj, pala duhet të dorëzojë projekt-konceptin, ku ndërtimi do të zhvillohet vetëm brenda kësaj pjese të parcelës, e cila sipas PZhK-së është zonë ndërtimore. Pjesë e njoftimit është edhe skica e PZhK-së për atë zonë dhe kopja e planit të datës 11.09.2023. Drejtoria për Urbanizëm, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se dokumenti i dorëzuar nga pala për kushte ndërtimore, për ndërtimin e objekteve të lagjes së banimit me etazhitet B+P+1 është në kundërshtim me Planin Urban dhe Planin Zhvillimor Komunal. Drejtoria ka kërkuar që pala të bëjë plotësimin e kërkesës. PZhK-ja ka qenë në diskutim publik prej datës 18.01.2023-18.02.2023. Më datë 01.02.2023 është nxjerrë vendimi i komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe propozimeve për PZhK-në. Më datë 26.04.2023 ka përfunduar raporti i komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për PZhK-në. Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe PZhK-ja është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës, më datë 03.05.2023. Gjatë periudhës të shqyrtimit publik dhe para dorëzimit në ministri, parcela 8952 nuk ka ekzistuar, sepse kjo parcelë është formuar nga bashkimi i disa parcelave. Gjatë hartimit të PZhK-së, edhe pse ishte paraparë vetëm një takim publik sipas ligjit, Drejtoria për Urbanizëm i ka organizuar mbi 12 takime, me qëllim që t'i tërheqim qytetarët që të bëjnë kërkesa të ndryshme në lidhje me parcelat e tyre, ku parashihet të investojnë. Ky ishte dhe mbetet momenti i vetëm ku propozimet

për investime në parcela mund të përfshihen, sepse PZhK-ja nuk mund të ndyshohet pas miratimit, në këtë kuvend dhe në ministri. Brenda zonës ekzistuese, në rrezen prej 50m nuk ekzistojnë ndërtime të objekteve të banimit, përveç një vikend-shtëpize me dimensione 3 me 5m, e cila është brenda zonën ndërtimore, por është ndërtuar pa leje. Inspektorati ka procesverbal, me të cilin e ka udhëzuar palën që të pajiset me leje ose ta rrënojë objektin. Pas vendimit të parë të ministrisë, i kemi dërguar shkresë zyrtares dhe departamentit ligjor. E kemi përsëritë shkresën e njëjtë, iu kemi drejtuar edhe ministrit të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe kemi kërkuar takim dhe krejt çka kemi marrë prej ministrisë ka qenë një telefonatë nga zyrtarja ligjore. Në bazë të kësaj, ka shkuar ankesa direkt në ministri. Ministria, më datë 16.01.2025, lëndën me nr.prot. 276/24, refuzon vendimin e dytë të Drejtorisë për Urbanizëm dhe obligon drejtorinë të pajisë palën me dokumentacion ndërtimor sipas PZhK-së, ligjit për ndërtim dhe udhëzimet administrative. Nëse i referohemi PZhK-së, atëherë pjesa e sipërfaqes që është brenda zonës ndërtimore është 84 ari dhe brenda kësaj zone Drejtoria për Urbanizëm është e gatshme të pajisë palën me kushte ndërtimore. Në shkresat që i kemi pranuar nga pala, është deklaruar që do t'i përdorë të gjitha format e presionit juridik dhe medial, deri te lëshimi i kushteve ndërtimore. Dua të theksoj qartë se, unë personalisht e as Drejtoria e Urbanizmit, nuk i nënshtrohem asnjë llojit të presionit, qoftë medial apo çfarëdo lloj natyre tjetër. Detyra jonë është që të zbatojmë ligjin dhe planet urbane në fuqi. Vendimmarrja jonë bazohet në kriteret profesionale dhe ligjore, si dhe çdo përpjekje për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në këtë proces është e papranueshme.

Kryetari: I nderuar kryesues i kuvendit, Arbër Zenuni, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të mediave, të LMT-së. Ndoshta do të ishte më mirë që kjo të ishte si pikë e veçantë e rendit të ditës, sidoqoftë ju falënderoj për angazhimin dhe kujdesin për këtë temë. I falënderoj gjithashtu të gjithë ata që kujdesen t'ia rrisin kompetencat kryetarit të komunës, që sipas ligjit, është e kundërligjshme që kryetari të ketë kompetenca për lëshimin e kushteve ndërtimore. I mirëkuptoj edhe mediat edhe qytetarët. Jam konsultuar gjatë me drejtorin dhe me palën. Nuk mund të ketë porosi nga ana e kryetarit të komunës, që dikush të merrë veprime të kundërligjshme pa u sqaruar deri në fund situata ligjore. Parimisht jam për të lëshuar kushte ndërtimore, mirëpo aspekti moral dhe aspekti ligjor janë gjëra që duhet të ndahen dhe duhet të kujdesemi që para se t'i lëshon kushtet ndërtimore për dikë Drejtoria e Urbanizmit, e cila është kompetente, pra, jo kryetari i komunës. Nuk ka ndodhur ndonjëherë në historinë e qeverisjes që kryetari i komunës të lëshojë kushte ndërtimore. Rrjedhimisht, kryetari i komunës mund t'i mirëkuptoj edhe ato akuzat që kinse po i "bllokun" milionat në Rahovec, që nuk është e vërtetë dhe ndoshta pas këtij takimi do të kujdesem me zyrën ligjore dhe avokatin dhe të shikoj nëse ka arsye dhe bazë për ndonjë padi për shpifje. Nëse do të ishte e mundshme që të jepet leja nga kryetari i komunës, nuk do ta zgjasja më shumë dhe do ta jepja menjëherë, natyrisht në pajtim me ligjin. Drejtoria përkatëse e urbanizmit i ka të gjitha aktet nënligjore dhe ligjin në fuqi, që patjetër duhet ta zbatojë. E dyta, ne po presim opinion ligjor nga departamenti ligjor i ministrisë përkatëse, qoftë edhe nga zyra ligjore e jona, që nëse ka ndonjë modalitet edhe kur PZhK-ja është në fuqi, atëherë pse jo! Unë e di që dikush ka dëshirë të bëjë "goditje nën brez", por nuk është mirë, sepse unë e kam kurrizin e fortë, shumë të fortë dhe kush mendon të më rrëzojë me kualifikime, me fabrikime, me konstruksione, me shpifje dhe me akuza e ka gabim. Nuk është fare me rëndësi pozita që jam sot, është shumë e rëndësishme që ne kemi kaluar procese, të cilat janë shumë më të rrezikshme dhe më sfiduese. Mos pritni që unë t'i them drejtorit për urbanizëm që, lëshoji kushtet ndërtimore e në anën tjetër do të vijë prokuroria të të arrestojë ty dhe zyrtarët e urbanizmit që merren me këtë punë. Duhet të jemi shumë të vëmendshëm që unë nuk kam asnjë autorizim që t'ia imponojë drejtorit të urbanizmit dhe as shefit të sektorit të urbanizmit që t'iu diktojë masat që duhet t'i marrin. Kush mendon kështu, ai është antishtet. Ju na njihni fare mirë! Ata që shkruajnë e merren me kualifikime, nuk mund ta dorëzojnë dhe nënshtrojnë as drejtorin e Urbanizmit, as kryetarin e komunës. Parimisht jam "për", mirëpo, nuk mund ta shkelim bazën ligjore dhe të ftojme prokurorinë dhe t'i themi: ejani tani merrni këta që kanë vendosur kundërligjshëm. Mos harroni, kryetari i komunës mund ta ushtrojë një ditë të drejtën që ta mbrojë interesin publik nga kualifikimet nxitëse, të cilat janë të pabaza dhe të paargumentuara. Jam pro pastrimit të bazës ligjore deri në fund dhe nëse na jepet leja, nuk ka nevojë të presim një muaj, por mjaftojnë 24 orë. Ne jemi në proces dhe brenda afatit besoj që do të hapim kontest, si dhe nëse na ofrohet një zgjidhje ligjore, kontesti mbyllet dhe jepen kushtet ndërtimore. Do të hapim kontest me ministrinë (qenka hapur) dhe shpresoj që nuk do të ketë nevojë që kontesti të mbyllet me gjykatë. Kujdesi i tepruar që dikush nga parapolitika të akuzojë kryetarin

e komunës për bllokim të miliona eurove, kur dihet paraprakisht që është inkompetent për këtë punë. Unë nuk e di se kush zyrtarisht fshihet prapa këtyre fyerjeve dhe insinuatave, por shteti jonë ka hetuesi, polici, prokurori dhe gjykatë. Jam i bindur që në emër të mbrojtjes të interesit publik, por edhe të pozicionit të kryetarit, ndoshta do të jem i detyruar të autorizojë avokat që të merret me shpifje, akuza, tendenca, insinuata dhe presione të cilat nuk shkojnë tek ne. Ju lus që të kontribuojmë të gjithë bashkë, ta japim informatën e saktë, sepse standarde të dyfishta nuk mund të aplikojë as kryetari e as drejtori, edhe jepja kushtet ndërtimore edhe zbatoje Planin Zhvillimor. PZhK-ja është kushtetutë që e ka marrë miratimin këtu. E nëse janë të zotë ata zyrtarët e ministrisë që hajnë para, dikujt ja kryejnë e dikujt jo, e në rastin konkret bëjnë standarde të dyfishta, edhe jepja edhe mos ja jep, mirë është mos të biejmë në këso kurthe as kuvendi i komunës dhe ndoshta është mirë që ky debat mos të vazhdohet. Kjo nuk ka të bëjë fare me palën, e cila synon të bëjë zhvillim ekonomik lokal. Kontesti është hapur me ministrinë dhe nëse ata thonë që t'i prishim kufijt ndërtimore, atëherë nuk presim ne. Ata po thonë që është aprovuar plotësisht ankesa, herën e dytë: shfuqizohet vendimi i Drejtorisë së Urbanizmit, por e kanë theksuar aty që të zbatohet Plan i Zhvillimor Komunal. Ai që nuk e zbaton PZhK-në bën vepër penale, e ai që është më i guximshëm këtu, le të del këtu, le ta nënshkruan dhe e ka përkrahjen morale nga unë. Në këtë situatë, ju lus për mirëkuptim, që mos të tentohet të bëhen lojëra ende pa u pastruar situata ligjore. Këto lojëra janë të turbullta dhe sa do i zoti të jetë timonieri, anija do të fundoset.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Informatën e prezentova, por nuk e pata hartën e shfrytëzimit të tokës sipas PZhK-së. Kjo është harta për pjesën ku po flasim. Këto dy parcela janë të palës, të cilat janë të përfshiera brenda zonës ndërtimore me 84 ari. Sipas Planit Zhvillimor, pjesa tjetër është zonë bujqësore. Në vendimin e dytë të ministrisë thuhet që, obligohet Drejtoria e Urbanizmit që kushtet t'i lëshojë në bazë të Planit Zhvillimor. Nëse ne jemi të gatshëm ta shkelim PZhK-në, atëherë pse e kemi miratuar?

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit komunal, media, të pranishëm dhe të gjithë ju që po na përcjellni. Këtu çështja është vetëm çështje vullneti, a po don të zhvillohet diçka komuna e Rahovecit, apo nuk don?... Këta e kanë zgjedhur një rrugë që nuk dëshirojnë. Tani, ju qenkat ata që po e mbron ligjin, ndërsa ne po e shkelim ligjin. Juve ju ka "shpërthyer" uji në të gjitha anët nëpër gjykata, duke i dërguar çdo ditë përfaqësuesit e komunës dhe duke paguar avokatë për lëndët që i keni në gjykatë, ndërsa neve na akuzoni që, ne po ju bëjmë shtytje ta shkelni ligjin. Ne po ju thomë që ju ta bëni një të mirë për këtë komunitet, për qytetarët e komunës së Rahovecit, po ju pa punën, sepse ka kohë që ata nuk po e shohin. Pasi u përmend ligji, unë i mora dy vendimet që ministria ia ka kthyer Drejtorisë së Urbanizmit dhe thotë: Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe ankesës së palës së ushtruar kundër vendimit 12 Nr.200 i datës 05.08.2024, e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit-Komuna Rahovec, ministria konstatoi që, kjo drejtori nuk ka vendosur drejt me këtë çështje administrative, sepse nga kjo drejtori nuk është marrë në konsideratë që, parcela e lartëcekur është pronë private dhe në këtë zonë nuk ka plan rregullues ku përcaktohet destinimi dhe kriteret e mendimit, andaj duhet bazuar në nenin 80, paragrafi 1 të ligjit Nr.04L/110. Do të thotë, procedurat duhet të vazhdohet sipas këtij ligji. Tjetër, ndërsa prona është private e palës dhe nga e njëjta është prezentuar me foto nga terreni dhe në rreze prej 50m ekziston objekti-shtëpi, këtu nuk po thotë as objekt vikendi e as bujqësore, si mund të jetë bujqësor me blloka dhe kush mund të na tregojë se a banon dikush aty, apo vetëm kur e punon tokën ose për vikend! Është objekt pa leje që ju keni dështuar ta rregulloni këtë çështje, që objekti mos të ndërtohet. Tani, në bazë të këtij lëshimi që e keni bërë, obligoheni që parcelës me këtë diametër t'ia siguron kushtet ndërtimore sipas kërkesës së bërë. Një diçka tjetër, kur ka filluar kundërshtimi i drejtorisë për lëshimin e kushteve ndërtimore, objekti pa leje atje, i cili ka më shumë se 3 vjet që është ndërtuar, do të thotë drejtoria kërkonte bazë se si t'i refuzojë kushtet. Ju keni dashtë të bëni luftë edhe me ministri. Ju keni marrë vendim edhe kundër ministrisë, sepse keni vazhduar me refuzim. Tutje, ministria e ka bërë edhe një vendim, që thotë: Moszbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të ligjit 04L/110 për ndërtim, shkelje thelbësore e të gjitha parimeve të ligjit të procedurës së përgjithshme administrative, në veçanti nenin 6 të këtij ligji, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Drejtoria e Urbanizmit sipas vendimit ka vepruar kundërligjshëm, duke mosshqyrtuar drejt shkresat e lëndës dhe duke mos dhënë as një arsyetim të qartë lidhur me rastin konkret, për shkak se nuk e keni marrë në konsiderat vendimin e organit epror. Ndërsa ky organ komunal, jasht afatit ligjor dhe kundërligjshëm refuzon kërkesën për lëshimin e kushteve ndërtimore. Bashkimi i parcelave që e

përmende, çka është e rëndësishme kjo? Parcela e ka numrin 8952 dhe në momentin kur pala e ka parashtruar kërkesën për kushte ndërtimore, parcela ka qenë një. Te Plani Zhvillimor Komunal, unë kam qenë në konsultim publik dhe grupi punues që e kanë prezentuar Planin Zhvillimor Komunal i kanë pranuar pyetjet dhe kërkesat prej atyre që kanë qenë prezentë. Njëri prej atyre është edhe Drilon Mustafa (AAK) dhe pyetjen që e ka bërë drejtuar inxhinierëve të grupit punues ka qenë: Çka bëhet me një parcelë kur gjysma është në zonë ndërtimore dhe gjysma mbetet jashtë, sipas PZhK-së? Përgjigja ka qenë që përfshihet komplet parcela si zonë ndërtimi. Ne e dimë që institucioni i kryetarit nuk lëshon leje, por institucioni i kryetarit është përgjegjës në atë çka bën drejtoria. Të paktën ju është dashur të bashkëpunoni me ministrinë dhe të tregoni vullnet, është dashur që ju ta dërgoni një shkresë dhe jo të prisni që pala të bëjë ankesë. Këtu kurrëfarë shkelje të ligjit nuk ka, ju nuk po doni zhvillim. E the që po interesohemi më shumë se pala. Janë 9 milionë € që po investohen dhe unë si përfaqësues i qytetarëve, kushdo që aplikon dhe që don t'i investojë 9 milionë euro, unë ia bëj argatin. Faktikisht duhet, sepse pala mund të refuzojë të investojë dhe në fund humbëse është komuna e Rahovecit. Që mos të dalim humbës, ne po ia bëjmë argatin kësaj pune, por edhe juve. Drejtoria në rast se ka pengesa ligjore mjafton të thirret në këtë vendim të ministrisë dhe nëse tejkalon përgjegjësinë e vet, përgjegjësinë në rastin më të keq ia kalon ministrisë nëse diçka nuk është në rregull. Ndoshta edhe e keni marrë me inatë këtë fare pune, nuk e di. Shikoni se çka thotë tjetër vendimi i dytë: Drejtoria për Urbanizëm në Komunë të Rahovecit lidhur me rastin konkret ka bërë shkelje të të gjitha parimeve, posaçërisht nenit 6, nenit 1,2,3, nenit 7, paragrafi 1,2, nenit 8 paragrafi 1,2, nenit 48 paragrafi 2 të ligjit Nr 05L/031 për procedurën e përgjithshme administrative, duke diskriminuar në çështjen e moslëshimit të kushteve dhe lejes ndërtimore në parcelën kadastrale Nr. 89520. Këtu nuk thotë, në pjesën ku nuk përfshihet si zonë ndërtimore sipas PZhK-së, as nuk thotë në pjesën ku përfshihet si zonë ndërtimore. Gjithashtu nuk është marrë në konsideratë se në këtë zonë nuk ka plan rregullues ku përcaktohet destinimi me kritere të ndërtimit, andaj duke u bazuar në nenin 18 të ligjit Nr.04L/110 për ndërtim dhe në fund e jep komentin: Nga të lartëcekurat, obligohet Drejtoria për Urbanizëm të veprojë sipas këtij vendimi dhe brenda afatit ligjor të zhvillojë procedurën administrative lidhur me kërkesën e palës, konform rekomandimeve të vendimit të parë të datës 18.10.2024 të organit të shkallës së dytë, të nxjerrë aktin administrative. Kjo është haptas, vetëm që nuk e kanë shkruar “o burrë, jepja kushtet ndërtimore, le të investon njeri”. Duke mos ia dhënë kushtet ndërtimore, ju jeni duke i shkelur ligjet, sepse këtu më shumë është vullneti juaj, se sa çështja e ligjeve. Lëndën mund ta dërgoni edhe në gjykatë, mund të hapni kontest administrative, por kush i paguan shpenzimet dhe kush është humbës në rastin deri sa gjykata të marrë vendim? Investitori mund të tërhiqet edhe nëse gjykata mund të vendosë në favor të tij. Humbësi këtu është vetëm Komuna e Rahovecit, sepse komuna nuk po arrin të krijoj një harmoni në mes investitorit, zyrës ligjore dhe Drejtorisë së Urbanizmit, për t'i dhënë zgjidhje dhe të përfitojmë të gjithë prej këtij investimi.

Albnor Mullabazi: Sa i përket pyetjes së asambleistit Defrim Kafexhiu: Drejtoria për Urbanizëm është brenda kornizës ligjore. Vendimi i parë, kur është hedhur poshtë është bërë në bazë të PZhK-së, 2023-2031, Planit Urban, Vendimit mbi ndryshim – plotësimin e vendimit të zgjerimit të kufijve ndërtimorë, Planit Gjeneral Urbanistik. Do të thotë drejtoria ka lëshuar vendim duke u bazuar në plane dhe ligje në fuqi. Sa i përket parcelës, deri në shqyrtimin publik të PZhK-së dhe pas vendimit të komisionit, i cili është i publikuar në ueb-faqe të komunës, aty kanë qenë mbi 10 parcela dhe në zonën ndërtimore kanë mbetë dy parcela me sipërfaqe 84 ari. Drejtoria për Urbanizëm ka lëshuar kushte në bazë të cilën e kemi. Vendimin e ministrisë je duke e lexuar vetëm në ato pjesë ku të konvenon ty. Vendimin duhet të lexohet mirë. Aprovohet si e bazuar kërkesa e Hamdi Cenës në Rahovec. Shfuqizohet vendimin 12 Nr.pro.200 e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm që të rivendosë me kërkesën e palës konform ligjit të ndërtimit, udhëzimeve administrative në fuqi dhe të nxjerrë akt administrativ. Drejtoria për Urbanizëm në bazë të vendimit të parë nga ministria e ka njoftuar palën që brenda sipërfaqes prej 84 ari mund të lëshohen kushtet ndërtimore dhe sipas PZhK-së pjesa tjetër e parcelës është jashtë zonës ndërtimore. Pala nuk është përgjigjur në njoftim që ta sjellë projektin që të ndërtohet në ato 84m² dhe pas kësaj Drejtoria për Urbanizëm e hedh poshtë kërkesën e palës, sepse nuk i plotëson kriteret dhe është jashtë zonës ndërtimore sipas PZhK-së. Pas kësaj, pala bën ankesë përsëri në ministri dhe neve na vjen vendimi i dytë i ministrisë. Në vendimin e dytë të ministrisë, i datës 16.01.2025, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Departamenti Ligjor e obligon Drejtorinë e Urbanizmit në Komunë të Rahovecit që të pajis palën me kushte ndërtimore sipas Planit Zhvillimor. Në vendimin e dytë ceket që Drejtoria për Urbanizëm

obligohet që palën ta pajis me kushte ndërtimore sipas Planit Zhvillimor Komunal. Te pjesa e kampshtëpizës, ku pala kapet, si dhe ministria me arsyen e rrezes 50m. Ajo shtëpizë është e ndërtuar brenda zonës dhe sipas PZhK-së. Është pa leje, ka procesverbale prej inspektoriatit që kanë kërkuar që pala të pajiset me leje dhe të njëjtët i kanë dërguar procesverbal për rrënim. Si komunë jemi duke bërë investime milionëshe, duke u bazuar në Plan Zhvillimor. E kemi zonën për energji të ripërtrishme në Kramovik, mullinjtë e erës në pjesën e Zatriqit dhe te pjesa mbi Oplotushë. Kjo procedurë ka mundur të kryhet në shqyrtim publik, vetëm nëse pala do të kishte interes për parcelën e vet, duke e bërë një kërkesë që prona e tij të futet në zonë ndërtimore. Bashkimi i parcelave ka ndodhë pas miratimit të PZhK-së, pas dorëzimit të PZhK-së në ministri. Në moment që komisioni e ka përfunduar punën e tij, ka ardhur në kuvend dhe e keni votuar pa asnjë ndryshim dhe prej atij momenti drejtoria dhe komuna e ka humbur qasjen e ndryshimit në plan. Parcelat janë bashkuar pas asaj kohe. Fletëpërcjellësja e dorëzimit të Planit Zhvillimor Komunal është më datë 03.05.2023, pas kësaj date, Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, nuk ka pasur të drejtë ta “ngucë” asnjë parcelë. Plani Zhvillimor nuk ndryshohet, për t’i bërë zgjidhje palës, atëherë duhet fillimisht të shfuqizohet komplet plani këtu në kuvend dhe ta bëjmë një plan të ri. Tani jemi në proces të hapjes së shqyrtimit publik për Hartën Zonale dhe si komunë, pasi bashkimi i parcelës ka ndodhë, do të interesohemi që pjesën e mbetur të parcelës me një kërkesë në ministri, që të përfshihet në zonë ndërtimore. Ne nuk jemi kundër asnjë investimi, por për momentin ky është realiteti ligjor që nuk mund ta shkelim. Kemi kërkesa tjera për lagje afër zonave ndërtimore, apo jashtë kufirit ndërtimor dhe nëse këtë rast e kalojmë me kuvend apo provojmë me ia gjetë formën, a do të jeni ju ata që për çdo lagje kërkohet të përfshihet në zonë ndërtimore? Nëse po, atëherë i bie që Planin Zhvillimor e kemi miratuar veç sa për “sy e faqe”.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Mendova të bëjë edhe pyetje tjera, por na marrin orientimin. Më vjen keq për palën, nuk e di a është këtu apo na përcjellë online. E kam një kërkesë të mirëkuptimit: nuk është mirë të bëni politikë me problemet e dikujt. Ai është investitor dhe kur kemi vullnet t’i ndihmojmë dikujt, duhe të gjejmë zgjidhje ta shtyejmë tutje. Praktikën e asamblesë komunale kanë thënë: ka pasur raste që në asamble komunale është nxjerrë vendim që të zgjerohet zona ndërtimore për ndërtim. Ka raste, nuk dua t’i përmendi me emra, sepse është joetike. Pala, ministria dhe ekzekutivi ndoshta kanë mundur të gjejnë zgjidhje duke e bërë një kërkesë në komunë, komuna përmes kryetarit në asamble dhe asambleja ta zgjerojë pjesën ndërtimore të parcelës dhe të lejohet ndërtimi, nëse me të vërtetë është interes i përgjithshëm i komunës së Rahovecit. Jo ta luajmë ping-pongut, “unë po e mbroj, ti jo, unë ia dua të mirën e ti të keqen”. Ai dëshiron t’i investojë milionat dhe ne duhet të kemi mirëkuptim, sepse nesër mund të ballafaqohemi edhe personalisht, apo një familjar i yni që ka interes për investim. Nuk besoj që dikush ka vullnet që ta stopojë dikë. Unë rekomandoj që, të shikohet mundësia që zona ndërtimore për atë parcelë të zgjerohet. Lejohet, ka praktikë, ka ndodhur dikur. E dyta, ta kemi në konsideratë efektin “domino”, sepse mund të vijë kërkesa të tjerat të vazhdueshme për zgjerim të zonës ndërtimore. Nëse me të vërtetë është interes, le të ndodhë zgjerimi i zonës ndërtimore, por jo ta bëjmë një situatë që, zyrtari i ministrisë, drejtori i urbanizmit, kryetari i komunës, asambleisti apo kushdoqoftë ai, të ballafaqohet nëse në hetuesi për qfarëdo formati për shkak të politikave tona që para opinionit të dukemi mirë. Kryetar, i kam edhe dy-tre pyetje në parim. E kam pasur një kërkesë rreth ndërprerjes së kontratës për furnizim me pelet, puna e çmimit të lartë. A keni marrë ndonjë veprim ose a e keni angazhuar zyrën ligjore që t’i dini format që ajo kontratë të ndërprehet, duke pasur parasysh që edhe operatorët kur nuk kanë lavërdi e ndërprejnë kontratën. E dyta, një informatë prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, bashkë me Drejtorinë e Financave, sa i përket kontratës së re të nënshkruar të segmentit prej udhëkryqit në Xërxë e deri në dalje të Fortesës – zgjerimi i rrugës 4 korsi me rreth 7.88 milionë€. Operatori që ka heq dorë, të na përcjelli një informatë se sa % të punëve i ka kryer, sa është paguar dhe a jemi në rregull me punën e bërë?! Faleminderit për kohën.

Kryetari: Faleminderit Burim! Nuk kam pasur rast ta inicioj atë kërkesë. Është diskutuar në kuvend çështja e kontratës për pelet dhe t’ju them të drejtën është shtrenjtë, por ndoshta në këtë fazë nuk guxojmë ta ndërprejmë kontratën për shkak të stinës ku jemi. Do ta shqyrtojmë mundësinë, por duhet ta shohim situatën dhe nevojën e objekteve publike. Sa i përket segmentit për të cilin fole, nuk jemi të kënaqur me punën aty dhe kontratën e kemi shkëputur me marrëveshje. Informacionin e jep të detajuar drejtori i Shërbimeve Publike. fjalët prodhojnë debat dhe ne, për sa kemi bërë, jemi të gatshëm të dëshmojmë në këtë sallë. Në qoftëse është dikush është shpirti i zhvillimit ekonomik, ne jemi

të gjithë, mos të merret dikush sikur po e bllokun, e dikush tani është thjeshtë “hasmi” më i madh kundër bllokimit. Mos të merremi kështu, sepse jemi njerëz, jemi të pjekur, jemi me përvojë, ndërsa dikush s'ka përvojë të mjaftueshme dhe duhet pasur kujdes në kualifikime. Pra, kundër zhvillimit ekonomik, ky kuvend, edhe sa mbaj mend unë, ka njerëz që janë edhe në përbërje të tjera të kuvendeve të kaluara, gjithmonë e kanë ndihmuar ekzekutivin e komunës për zhvillim. Duhet të harrojmë dikush që mund të mendojë, mund të thotë dikush shkelje të ligjit, s'i jap mundësi, sepse unë i di kompetencat e mia dhe drejtori i Urbanizmit e di gjithashtu. Ju e dini që në ballafaqohemi me presione dhe rezistencë. Unë kam hy edhe në projekte shumë më të rënda, që për dikë janë rrezik edhe në ëndërr. I kam mbyll shtëpitë e natës. Unë pajtohem plotësisht me Burimin që dha një konotacion, për të cilin mua s'më kujtohej ndoshta sot kur tha: “Mos të del dikush sikur është një palë e caktuar dhe dikush sikur është në një palë të caktuar”. S'ka të bëjë me vullnet kjo, vullneti parimisht është një dhënie e kushteve ligjore. Por, ne duhet të jemi të kujdesshëm, sepse dikush i thotë drejtorit: jepja kushtet ndërtimore dhe kur drejtorin e thirr Prokuroria, i ngrit akuzë, thonë: ju nëpër gjykata e prokurori po rrini. Këto barcoleta kanë ekzistuar para luftës dhe 26 vjet pas luftës nuk mundet drejtori i urbanizmit të bëjë veprimet. Drejtori ua tregoi një zgjidhje dhe ndoshta zgjidhja më e mirë do të jetë Harta Zonale, a e kuptoni? Sepse aty ekziston një mundësi dhe këtu tani po dua të shpreh mospajtim me Burimin. Pra, harta zonale do t'i nënshtrohet diskutimit publik, pra, meqenëse kemi parcela të bashkuara tashmë, edhe pse më vonë. Ne mund të gjejmë modalitetin që ndoshta t'i japim një epilog pozitiv përmes Hartës Zonale. Harta Zonale ka mundësi në muajin mars, merret vendimi për diskutim për shqyrtim publik në këtë kuvend. Presim, nëse mund të gjejmë nga dera e pasme, përmes një dokumenti strategjik, sepse ju e dini që PZhK-ja është dokument strategjik - është kushtetutë e komunës, siç është edhe harta zonale nesër. Janë dy dokumente që nuk guxon t'i shkelë askush, as me kuvend madje, sepse krijohet precedent. Do t'i shohim modalitetet tjera, nëse mund ta rrisim kufirin ndërtimor përmes shqyrtimit publik për Hartën Zonale. Ju e dini rastin e Orllatit! Është bërë fjalë për një projekt humanitar dhe kemi dashur të bëjmë me leje, projekt humanitar, tërësisht humanitar - puro humanitar. Në fund na e kthyen kundërligjshëm. Pra, vetëm vendimin e këtij kuvendi, ku të gjithë u dakorduam. Pra, ata thonë është përgjegjëse Komuna e Rahovecit, drejtorja përkatëse e urbanizmit dhe meqenëse është drejtorja përkatëse e urbanizmit, unë ju lutem, mos e gjykoni kryetarin, se jam kryetar i të gjithëve. Kryetari s'jep kushte ndërtimore, nuk është i autorizuar. Unë kam biseduar me drejtorin, zyrën ligjore, me avokatë, me kryetarët e komunave përreth që të gjejmë një modalitet për ta thyer kufirin ndërtimor pa e shkelur ligjin. Për moment duhet ta pastrojmë bazën ligjore. Hapet kontesti në gjykatë. Në qoftëse Harta Zonale vjen shpejt, e rregullojmë hartën, vetëm e tërheqim dhe mbyllet tema. Ndërsa edhe një herë drejtori e ka potencuar dhe po solidarizohet me Albënorin. Për 84 ari, të hënën le të vjen për kushtet ndërtimore, se unë jam praktik. Aty ka të drejtë, me ligj mund t'i jepet e tani ai le të vazhdon edhe në pjesën tjetër, ndoshta vjen ndonjë legalizimit. A e kuptoni? Por ne t'ia nisim aty. Aty duhet të pajiset ashtu siç e thotë ligji. Prandaj, mos ta keqinterpretojmë temën edhe një herë, sepse “dy duar janë me një kokë” dhe në momentin kur dikush më akuzon se kryetari i komunës bllokun investime multimilionëshe, duhet të kemi parasysh çka flet e çka po shkruajmë, sepse unë mbroj jo interesin personal, por jam inkompetent për temën për të cilën akuzohem dhe unë e di që nuk i kanë për disa njerëz që kanë dëshirë të bëjnë tema, të bëjnë inskenime, të bëjnë filma, të bëjnë teatër, të bëjnë lojëra, s'kanë punë me drejtorin, ata kanë punë me kryetarin, sepse mendojnë që kryetari po e bllokun punën, jo, gabim e kanë ata. Kur t'ju shkon prokuroria te dera, mos të dorëzohen dhe mos të vijnë tani mua të më kërkojnë ndihmë, se unë s'kam qasje në prokurori. Unë nuk kam të drejtë të ndërhyj në prokurori, jam jashtë temës tani. Unë kurrë s'kam bërë padi, përveç një herë një padi me Gjergj Gojanin, të cilën e kam fituar. Krejt Kosova është ngitur në këmbë për këtë gjë, ka qenë në proces zgjedhor, sepse qëllimisht është bërë kjo punë dhe kanë shkuar aq largë sa që kanë thënë që Smajl Latifi po e shkel Kushtetutën. Nuk e shkeli kushtetutën unë edhe nëse kryetarja e gjykatës kushtetuese tenton të ma mbush mendjen për ta shkelur. Ju lutem, unë palën e kam takuar në zyrë dhe kemi biseduar haptas dhe ia kam shprehur dëshirën dhe vullnetin për të kryer punë. Mirëpo, ja që ligji është një pengesë për mua në këtë moment dhe nuk do të thotë që në një moment më të përshtatshëm me hartën zonore nuk mund të bëhet ky korrigjim ose ky plotësim. Andaj, ju ftoj për mirëkuptim. Nuk është çështje që dikush e don atë zotniun Cena më shumë se unë. Si menduat ju që kryetari i komunës është kundër investimit prej 9 milionë euro. Ju lutem, mosni kështu. Kualifikimet kur t'i bëni, bëni pak më të mençura, sepse kryetarin e komunës dhe drejtorin e urbanizmit, kurrë nuk e mundni nëse veprimi është i kundërligjshëm. Këtu nuk jemi duke ngrënë bari. Ju mendoni se s'e kemi konsultuar askënd deri tani? I kam pyetur për interpretim edhe avokatët, profesionistë, a e di si është kjo gjendje? “Bëje, por inshallah s'e shohin”. Dua t'i tregoj qytetarëve të Rahovecit që ne kemi vullnet, por në këtë rast, tani për tani është ftesë për veprim të kundërligjshëm.

Prandaj, edhe një herë po them, unë i admiroj dhe ua marr lakmi dhe i vlerësoj ata që janë shpirti i zhvillimit ekonomik të kësaj treve, si puna jote që po jep mesazhe pozitive, por edhe unë jam për, a e kupton? Mos i merr këtu, unë i marr këto për njerëzillëk dhe me respekt. Nuk jemi të kundërt, a e kupton? Po jemi të kundërt, se nesër, ky burri këtu të bëhet subjekt i hetimeve. Është tepër e gabuar të thotë dikush që mungon vullneti, mungon njerëzishmëria, ju mungon diçka, ju mungon kjo, ju mungon ajo. Jo, jo. Hajde ti nënshkruaje, unë jam pas teje. Hajde nënshkruje, sot unë e shkarkoj këtë dhe po të ngarkoj ty.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit edhe një herë, do të ishte mirë që kjo të ishte si pikë e veçantë, meqenëse e kemi shfrytëzuar të drejtën edhe për çështje të tjera. Një përgjigje për drejtorin: Në vendimin e dytë që e ka lëshuar ministria, the që ka dërguar ministria përmes PZhK-së të nxjerrët vendimi. Nuk është e vërtetë. Në asnjë vendim nuk thuhet ajo. Këtu thotë: Nga të lartpërmendurat obligohet, domethënë që ky udhëzim i fundit, ky paragraf është disa. Merre një jurist, merre Sinanin dhe konsultoj dhe ju tregon. Nga të lartpërmendurat, duhet Komuna e Rahovecit të veprojë sipas vendimit A182/24 të datës 18.10.2024. Vendimi 182/24 thotë që, bazuar në të lartcekurat, obligohet organi i shkallës së parë të veprojë sipas këtij vendimi, lidhur me kërkesën e palës, konform Ligjit 04L/110. Nuk thotë të veprojë sipas Planit Zhvillimor Komunal, por thotë: obligohet organi i shkallës së parë të veprojë sipas vendimit A182/24, lidhur me kërkesën e palës konform Ligjit 04L/110. Kjo është bazë e mjaftueshme që me pasë vullnet për ta përfunduar këtë punë. Mua po më vjen keq që kryetari bën kualifikime kundrejt anëtarëve të kuvendit, apo kundrejt kujtdo tjetër, që dyshon në sinqeritetin e kërkesave tona dhe sinqeritetin e punës sonë. Çdo kërkesë që e paraqesim edhe çdo propozim që e paraqesim, e themi me plot sinqeritet, edhe e paraqesim për të mirën dhe për interesin e përgjithshëm. Mua po më vjen keq që nëse në bazë të këtyre dy vendimeve të ministrisë nuk keni bazë të mjaftueshme për të lëshuar lejen, për mua është e pakuptueshme, përveç dyshimit që nuk doni ta lëshoni. Ju ftoj që të konsultohemi edhe një herë në zyrën ligjore, por edhe një shkresë të dërgoni në ministri për të kërkuar ose për të pyetur drejtpërdrejt a mundet. Faleminderit! Atëherë fjala është për drejtorin. Faleminderit! Kryesues, edhe një sqarim jashtë kujtimit apo jo.

Albnor Mullabazi: Para se të marrim vendimin e dytë e kemi konsultuar zyrën ligjore, jemi konsultuar edhe me departamentin e planifikimit, në të njëjtën ministri. Departamenti ligjor i asaj ministrie nuk na ka dhënë mundësi të takohemi. Në shkresën e dytë e kemi cekë edhe ministrin dhe më pas janë drejtuar me telefonatë. Pra, Departamenti i Planifikimit thotë që ta zbatoni veprimin e ministrisë, derisa ka rekomanduar, ka urdhëruar, duhet zbatuar dhe shumë mirë po e thekson. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, që të pajis me kushte ndërtimore sipas dokumenteve të planifikimit, PZhK-së, Ligjit për Ndërtimin dhe udhëzimet administrative. Lënda ka shkuar në kontest administrativ me ministrinë, por më tutje vazhdojmë kontestin me ministrinë dhe merret vendimi.

Drilon Mustafa: Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin dhe të gjithë këtu. Është e vërtetë që ajo që tha drejtori, që kur është bërë PZhK-ja kemi pasur dëgjime publike dhe i kemi diskutuar këto tema, duke u bazuar në komunat e tjera, se kanë pasur probleme të ngjashme. Ky projekt, domethënë, është i pari si lloj i tij dhe sigurisht ka sfida edhe për institucionet edhe për organet kompetente. Problemi i parë është edhe te pala, që s'ka bërë kërkesë për të zgjeruar zonën e ndërtimit. Por nuk do të thotë se zona e ndërtimit nuk është shumë e ngushtë dhe nuk mund të zgjerohet. Dua të them që është projekt konceptual. Projekti konceptual mund të ketë ndryshime, duke u bazuar në ligje të tjera. Ligji i ndërtimit, 04L/110, neni 6, neve na lejon në rrezen 50m. Nëse në parcelë në rreze 50m ka ndërtime të tjera, ne kemi të drejtën për leje. Unë e kam marrë lejen në disa raste të tilla, edhe kur ishte në fuqi PZhK-ja. PZhK-ja nuk e ndalon, por e lehtëson edhe e liron nga taksat e tokës, sepse e ka parashikuar, por nuk na ndalon nëse në rrezen 50m ka ndërtime të tjera. Ky nuk është mendimi im, por besoj që mund të konsultoheni me të tjerët dhe kjo pikë, në bazë të kësaj pike, mendoj se mund t'i japim kushtet ndërtimore, gjithmonë duke u referuar edhe ministrisë. Ministria po na sugjeron në bazë të ligjit L04/110 dhe nëse gjërat ministria i lehtëson, mund të marrim këtë pikë, PZhK-në, edhe t'i lëshojmë kushtet ndërtimore.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve dhe gjithë të pranishmit në sallë! Unë desha të them që para miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, ndoshta edhe unë edhe Defrimi kemi faj, sepse është dashur që atëherë ta ngrisim zërin që gjendja mos të shkojë kështu te parcelat. Nuk e di a lejohet kjo punë, por nëse lejohet duhet të bëhet ashtu siç janë parcelat, zig-zag. Unë e mora fjalën për të ngritur një çështje tjetër. Ne në fshatin Celinë kemi një problem që prej luftës, në vitin 1998, kemi pasur një lum që përshkon mes Celinës dhe Krushës. Të kalohet aty ka qenë e pamundshme. Me vetëiniciativë i kemi marrë disa hapa dhe i kemi vendosur disa gypa, të cilët ende janë aty edhe pas 26 viteve. Tani kur ka të reshura të dendura, ka probleme, sepse mbeturinat barten dhe gypat bllokohen.

Aty, që 26 vjet nuk është menduar të bëhet një urë edhe pse ajo rrugë është kryesore, përveçse e lidh Celinën me Krushën, lidh edhe shumë fshatra aty. Pse deri tani nuk e ka parashikuar asnjë qeveri që do ta marrë përsipër atë punë? Të bëhet një urë e mirë, që të parandalonte rrëshqitjet aty dhe të mos vijnë deri te vështirësitë e tjera. Na keni paguar edhe dëme të konsiderueshme në Krushë dhe në Celinë. Ishte një projekt aty, erdhi deri te ura dhe nuk është kryer ura. Ky projekti tjetër, është diçka që lidhet me Hoçën e madhe. E kuptoj që komuna nuk ka buxhet, e dimë, por edhe ura na ka mbetur pa u përfunduar, ky është problemi kryesor. Kështu që kryetar, pyetja është: Kur mendoni që ta bëni këtë urë, në mënyrë që kur të kemi vërshime nuk do të kemi probleme?

Albnor Mullabazi: Dua të t'i përgjigjet asambleistit Rasim! Sa i përket PZhK-së, gjatë shqyrtimit jemi munduar që t'i mbajmë parcelat brenda kufirit dhe t'i përfshijmë në zona ndërtimore. Në këtë rast, bashkimi i parcelave ka ndodhur pasi ka kaluar shqyrtimi publik. Kjo hartë e shfrytëzimit të tokës, e cila nuk është ndryshuar, është e publikuar në ueb-faqe të komunës. Burim, nëse kjo zonë ndërtimore nuk respektohet, atëherë pse e kemi miratuar një plan.

Kryetari: Rasim, e kemi një kontratë të re me një kompani, ku përfshihet edhe ura që lidh Celinën me Krushën. Është fat i mirë që kontratën e kemi me Mendin, e kemi pasur me dikë tjetër dhe shkëputja e kontratës na ka marrë kohë dhe tani jemi të vetëdijshëm që nuk kemi buxhet të mjaftueshëm, por mendoj se do të kryhen punët. Do të mbyllen punët edhe ura do të vazhdohet. Pra, parashihet që ajo urë të mos jetë ashtu siç është, por edhe i gjithë shtrati i atij lumi. Mendi kudo që ka punuar, ka bërë punë të mira, sidomos në shtratin e përrënjeve. Nuk e di nëse ky ishte specifikisht ajo që kërkove. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i kësaj kontrate është Albnori dhe besoj se unë dhe ai do të bëjmë çmos që të kryhen punët.

Vlora Vuçitërna – Çmega: I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë, media dhe të gjithë të tjerët që po na ndjekin, përshëndetje! Unë kësaj here vetëm dëshiroj t'u uroj suksese kandidatëve për infermierë, në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë për 5 pozita. Uroj që të pranohen më të mirët. Ndërsa sa i përket konkursit të dytë të shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë për pozitën zëvendësdyrëtor në QKMF, nëse nuk gaboj, është pozitë e re. Dua t'i drejtim direkt kryetarit. Është supozimi im, a do ta pranoni zotëri Ahmet Latifin në këtë pozitë? I cili është i afërmi juaj i ngushtë. Siç po shohim të gjithë, para se të përfundojë mandati, po doni një herë t'i rehatoni të gjithë të afërmit dhe pastaj ta përfundoni mandatin.

Kryetari: I bashkohem urimit për kandidatët që mund të aplikojnë. Kryetari i komunës nuk është fare kompetent. QKMF-ja e ka statutin e vet dhe personeli ka planin e vet për këtë. E kush punësohet aty, duhet t'i plotësojë kriteret e konkursit, t'i zhvillojë procedurat deri në fund dhe a punësohet ai ose ai tjetri, unë nuk jam i sigurt që kontribuoj nëse përgjigjem, sepse nuk ka nevojë as të komentohet kjo gjë. Ndërsa sa i takon rehatimit të këtij e atij, ne i respektojmë vendimet e çdo institucioni. Mos merremi me kualifikime, se edhe ty të punësohet dikush, asaj, atij dhe këtij, jemi vend i vogël. Nuk e di unë kush punësohet dhe kush s'punësohet, këtë që e the për fund të mandanit, mos e lidh, sepse gjatë do të kemi aleancën në komunë, por atje s'po flasim, por këtu do të kemi gjatë.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje ryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asamblistë, vëzhgues. Unë fillimisht e përshëndes fitoren e CDU-së në Gjermani. I uroj suksese! Gjithashtu e përshëndes takimin Zelinski-Trump dhe shpresoj që kjo të kontribuojë në aleancën tonë të përbashkët në luftën ndërkombëtare kundër Rusisë. Tani desha të kaloj pak te projektet tona. Aty e përmenda Mendin, mirë që Mendi, por që edhe në Krushë te drini që dy vjet rruga është e keqe dhe disa kanalizime kanë mbetur keq. Te pastrimi i rrugëve, nëse ka mundësi ligjore që unë ta kem atë kontratë, sepse kam presion e sidomos në pjesën e muzeut të masakrës. Në fund, kryetar, nuk e di, ndoshta do t'ju duket qesharake, por sot ka ndodhur një incident. Më ka sulmuar në mëngjes një qen, te puna ime në Celinë. Vitin e kaluar ma keni dhënë një përgjigje që është një operator që ka një kontratë. Unë nuk e di, as po dua të supozoj se kush është operatori, por na kanë kapluar dhe mirë është të shikojmë që kjo çështje të zgjidhet një herë e përgjithmonë, si në Krushë ashtu edhe në qytet.

Kryetari: Unë jam i detyruar të them të vërtetën, të veproj me të vërtetën. Në grantin e performancës nuk na ka lejuar atë projekt që e përmende në Krushë, na ka hequr ministria apo qeveria aktuale, sepse ende është qeveri. Ne jemi detyruar të planifikojmë mjete, prap nuk kemi mjete të mjaftueshme, ndërkohë që kontrata është më e madhe. Operatori do të rifillojë punimet. Nëse do ta kishim atë 1.6 milion euroshin, unë do t'ja kisha vendosur mbi 500 mijë €, ashtu siç ia kam dhënë projektit që lidhet me Hoçën e vogël, në këtë rast nuk më kanë lejuar. Do ta ftoj më operatorin zyrtarisht që t'i rifillojë punimet në kolektorin e ujërave të zeza. Nuk e di Sefë, nëse ty të ka hangër qeni, por e di që një fëmijë sot e ka grithur dhe atë duke shkuar në shkollë. Ne jemi në hall. Jemi në hall edhe si institucion, si shtet. Është e vërtetë se kemi një kontratë, por po ashtu E kemi edhe një ligj për mbrojtjen e kafshëve që parashikon

çfarë s'duhet të bëhet me qentë endacakë. Tani, operatori që është në kontratë, ai e bën punën e vet, i bën disa veprime që janë brenda kornizës ligjore. Përndryshe, strehimore ju e dini që s'kemi. E dini që ky problem ndodhi në Podujevë edhe dy-tri dite, po ndodh edhe në komunat e tjera, ka ndodhur edhe sot dhe fati se s'u bë më shumë. Ne do të shohim çfarë mund të bëjmë brenda kornizës ligjore dhe ndonjë hap më tutje që të zbutim gjendjen, ose të zvogëlojmë rrezikun e kërcënimit nga qentë e rrugacakë. Gjithashtu edhe unë i përshëndes marrëveshjet! Uroj që Kosova të ketë një qasje serioze ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Përballë nesh është një objekt banesor kolektiv që para disa vitesh është djegur çatia e këtij objekti. Këtë çështje e kanë ngritur më herët disa kolegë të tjerë në seanca, por prej asaj kohe nuk ka pasur asnjë lëvizje. Banesat që gjenden nën këtë çati pësojnë dëme të konsiderueshme, për shkak se tani po rrjedh uji dhe po ka dëme në ato banesa, në mungesë të çatisë. Disa nga banorët janë të gatshëm të kontribuojnë me participim për ndërtimin e çatisë, por për shkak të kostos së lartë, nuk është e drejtë që vetëm disa individë të marrin përsipër të kontribuojnë në këtë çështje. Cila është mundësia që komuna t'u dalë në ndihmë këtyre banorëve? Edhe pse e dimë që kjo ndërtesë nuk ka as pranim teknik e as leje ndërtimore, madje disa prej banesave në këtë hyrje nuk u dihet as pronari. Singërisht do të doja të dija nëse ka ndonjë mundësi sado të vogël nga komuna që t'u dalë në ndihmë atyre banorëve, për shkak se ata banojnë aty dhe duhet të bëhen banesat e tyre të banueshme.

Kryetari: Merisë, e keni ngritur një çështje të mirë. Është e vërtetë që objekti është pa pranim teknik dhe pa leje, gjithashtu edhe objekti ku jemi është pa pranim teknik dhe pa leje. Ne kemi një kod për bashkëfinancim dhe mund të marrim masa dhe mund t'i ndihmojmë. Bëni një kërkesë të banorëve. Na e sjellni dhe nëse jeni dakord për një bashkëfinancim ose diçka të tillë, unë jam dakord.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Është mirë të mbajmë një rend sipas procesit që kemi votuar. Tani, nuk e di a jemi te pyetjet dhe përgjigjet, apo te informata që na dha drejtori. Kur të na njoftoni kur të përfundojë pika e rendit të ditës, të jemi në dijeni se ku po fillojmë dhe ku po mbarojmë, e jo të vazhdojmë vazhdimisht me debate, si me drejtorin, si me kryetarin. Kryetar, e përmendët që nuk kanë pranim teknik. A mund të na njoftoni se cilat objekte shkollore kanë pranim teknik në komunën e Rahovecit, apo edhe QKMF-ja. Përderisa the që kuvendi nuk ka pranim teknik, cilat objekte kanë? Pastaj kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike.

Kryetari: E para, jemi në pikën e dytë të rendit të ditës, pyetje dhe përgjigje. Besoj që jemi në atë pikë.

E dyta, ne folëm për objektin këtu dhe objektet banesore atje, që janë pa pranim teknik. Besoj se jeni në dijeni, pavarësisht se ne me një rekomandim të USAID-it dikur është marrë një rekomandim që situacioni i fundit të konsiderohet pranimin teknik gjatë një projekti. Mund të kemi shkolla, të cilat janë ndërtuar gjatë etapave të ndryshme të historisë dhe mund të mos kenë leje ndërtimi. Mirëpo, objektet të cilat janë ndërtuar në këtë mandat, janë kryesisht objekte shkollore dhe janë të pajisura me leje, ndoshta ju mungon leja kundër zjarrit. Ne mund t'ju ofrojmë një informatë përmes drejtorit të urbanizmit.

Lirigzon Kastrati: Një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike: Drejtor, keni kontratë për kubëzimin e rrugëve në fshatra dhe lagje të qytetit. Po më intereson, kur do të fillojnë punimet, të më thoni disa rrugë që i dimë në plan dhe a do ta kishte prioritet kubëzimin e rrugës Hoçë e Vogël-Nagavc, që ka mbetur për një për një gjatësi 500-600m.

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Lirigzon, kemi kontratë, është e publike dhe e specifikuar dhe mund t'i shihni me emra të gjitha rrugët që janë në kontratë. Kjo kërkesë ka ardhur pas këtyre kontratave që i kemi lidhur, me vonesë. Ne do ta shqyrtojmë, e kemi një mundësi dhe do të shohim mundësinë që ta përfshijmë edhe atë rrugë.

Kryesuesi: Atëherë, të nderuar anëtarë, në qoftëse nuk keni pyetje dhe diskutime të tjera për pikën e dytë, besoj që e kemi përfunduar. Me lejen dhe mirëkuptimin tuaj, shkojmë në një pauzë...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në mbrojtje të "Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë" në kategorinë: Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit:

Afrim Oruqi: I nderuar kryetar, kryesues, kuvendarë! Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Ligjit për Mbrojtje të Natyrës, Statutit të Komunës dhe propozimit profesional për rikategorizimin e monumentit të natyrës, si dhe në bazë të vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i komunës ju propozon vendimin për vënien në mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë në kategorinë Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit. Me këtë vendim vihet në mbrojtje Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë në kategorinë - monument i natyrës në komunën e Rahovecit, me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik, i cili ka për qëllim mbrojtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore, si dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, që përfaqëson vlerë tërësore

natyrore. Bëhet fjalë për dy zona, zonën kadastrale në Gexhë dhe në Xërxë. Sipas këtij vendimi, duke u bazuar në të gjitha ligjet që i përmenda më herët, në zonën kadastrale Gexhë, bëhet fjalë për njëzet e pesë hektarë, një ari e pesë metra katrorë. Prej kësaj sipërfaqeje të përgjithshme, në këto parcela ka pronë publike dhe pronë private. Janë gjithsej 15 hektarë, 60 ari e 18m² pronësi të Komunës së Rahovecit. Kjo sipërfaqe mbetet në mbrojtje të Monumentit të Natyrës së Kanionit të Drinit të Bardhë. Ndërsa sipërfaqja prej 9 ha 40ari e 97 m² është në pronësi private në Gexhë. Në nenin 2, pika 2.1 deri në pikën 210 i keni të përmendura të gjitha parcelat, numrat e parcelave, zonën kadastrale dhe sipërfaqet në Gexhë, që mbeten në zonë të mbrojtur. Pa dashur të marr kohë edhe t'i listoj, t'i lexoj një nga një. I keni përmendur në këto dhjetë parcela, domethënë janë 10 parcela me sipërfaqe, me numër, në zonën kadastrale Gexhë. Sipas propozimit të kryetarit, këto mbeten në mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë në Gexhë. Po kalojmë te pika 3, zona kadastrale - Xërxë. Sipërfaqja e përgjithshme që do të jetë në mbrojtje të zonës së Kanionit të Drinit të Bardhë është 30 ha, 95ari e 50m². Sipërfaqja prej 30 ha, në pronësi publike në Xërxë, ndërsa në pronësi private është 93 ari e 9m². Në pikën 3.1 deri në 3.9, listohen parcelat, numrat e parcelave dhe sipërfaqet në zonën kadastrale në Xërxë, në pronë publike dhe në pronë private që mbeten në zonë të mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë. E kemi edhe propozimin profesional të komisionit para jush. Kjo është harta, harta bazë e komisionit të formuar prej ministrisë, janë nëntë anëtarë. Ky propozim profesional ka marrë edhe pëlqim prej ministrisë. Kjo rruga, kjo ngjyra e kuqe është propozimi sipas këtij propozimi profesional, sipas pëlqimit të ministrisë, që do të jetë në zonë të mbrojtur, domethënë sipërfaqja në ngjyrë të tyre që i prek dy zona, zonën e Gexhës dhe të Xërxës, kjo është rruga Rahovec-Xërxë-Gjakovë, do të thotë komplet sipërfaqja në anën e majtë të rrugës në drejtim të Rugovës me të gjelbër, hiqet prej zonës së mbrojtur, përveç një pjese të sipërfaqes dhe nga kjo pjesa më të kuqe, ky trekëndësh, më të kuqe përfundi i Urës së Fshajtë, vazhdon të mbetet pas këtij vendimi në zonën e mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë. Përkaj rrugës në drejtim të Gjakovës, prej fillimit aty ku kthehemi për në Gradish, në gjatësi prej 650 metra në drejtim të Gjakovës, me gjerësi, në fillim me 130 metra gjerësi brenda, këto që po i shihni janë parcelat private dhe këto dy parcela që janë të theksuara me ngjyrë më të gjelbër më të theksuara, janë parcela shtetërore. Këto hiqen prej zonës së mbrojtur. Domethënë, gjatësia prej Gradishit, ku kthehemi në drejtim të Obeliskut, deri tek pika ku përfundon, gjatësia është 650 metra, ndërsa në fillim gjerësia brenda territorit në drejtim të Nagjecit është 130 metra dhe në fund është 100 metra. Këto janë të drejtat dhe obligimet që ky vendim i përcakton, që i ka shkëputur prej Ligjit për Mbrojtje të Natyrës. Shkruan saktësisht se çka ndalohet dhe çka lejohet në këtë sipërfaqe, bazuar gjithmonë në propozimin profesional që ka bërë ai komision i themeluar prej Ministrisë së Mjedisit, i cili ka nëntë anëtarë. Shumica prej tyre ose të gjithë janë të fushave përkatëse, profesionistë të lëmive për të cilat po flasim. Neni 8 I vendimit: me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01 Nr.352-13, i datës 9 prill 1986. Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Drejtoria e Kadastrës, do të kujdeset për zbatim të këtij vendimi. Po ju ftoj që pas shqyrtimit e votoni propozim-vendimin për mbrojtje të Kanionit Drini i Bardhë.

Burim Krasniqi: Faleminderit, drejtor! E kam një pyetje dhe dy kërkesa. Pyetja e parë: A do të specifikohet me një vendim tjetër, apo është e rregulluar me diçka që në zonën që hiqet prej zonës së mbrojtur se çka ka të drejtë të ndërtohet? A ka nevojë të nxjerrim vendim dyfishtë, që mos të ndodh, s'po them sot, po nesër, pas dhjetë vjetëve, që të lejohet diçka që e degradon atë zonë. Drejtor, kërkoj dhe propozoj që kur bëhet vendimi final, që kryesuesi të nënshkruajë, të jetë pjesë e vendimit harta e prezentuar prej drejtorit për formatin se si do të duket zona e mbrojtur. Vendimi për zonën e mbrojtjes le të jetë konform hartës bashkëngjitur sipas prezantimit që është bërë sot këtu. Kërkesa tjetër: Kjo zonë që është 650 metra gjatësi rrugore prej udhëkryqit rrugës për Ratkoc dhe te rruga për Ratkoc shkon 130 metra dhe te pjesa e fundme 650 metra. Ju kërkoj që t'i vendosni koordinatat e sakta, sepse në një pjesë parcelat janë të ndara dhe një pjesë është e nxjerrë prej parcelës 772-1 (nëse nuk gaboj), pothuajse e përfshin të gjithë këtë parcelën me të kuqe. Kërkoj që t'i vendosni koordinatat e sakta.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit. Dua të filloj me një përshkrim të raportit që e ka bërë ky komision prej 9 anëtarëve që është prej Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Në këtë komision, prej 9 anëtarëve, 2 janë prej komunës së Rahovecit, që është drejtori i Gjeodezisë, që e prezantoi pikën dhe është drejtori i Urbanizmit, Albtor Mullabazi. Këtu po përshkruhet pak a shumë se cili është qëllimi, çka është ky kanion dhe ky monument natyror që po synohet të mbrohet prej shtetit, në këtë rast

prej Komunës së Rahovecit. Është një vendim i vitit 1986 që e përmendi drejtori, që e vlerëson dhe e përcakton këtë kanion si monument i mbrojtur natyror. Është i veçantë, ka një rëndësi të veçantë për Komunën e Rahovecit, që është vendi më i bukur dhe pasuria natyrore që komuna jonë e ka. Ne e kemi përgjegjësinë që ta ruajmë, ta mbrojmë dhe ta fuqizojmë si vend turistik për komunën. Këtu te objektivat, po thuhet që harmonizimi i ligjeve për mbrojtjen e natyrës është i vetmi argument që neve na duhet për ta ndryshuar, për ta harmonizuar me ligjet që janë aktuale në Kosovë edhe me marrë një vendim të ri, sikurse po e prezanton drejtori, në këtë rast në emër të ekzekutivit. Tani, objektivat tjera janë kryesisht për kultivimin, për menaxhimin dhe për zhvillimin e zonës së mbrojtur, rivitalizimin e ekosistemeve të dëmtuara, ndaljen e degradimit, rivendosjen e kushteve ekologjike në ekosistemet dhe habitatet e degraduara. Kjo sipas legjislacionit në fuqi, ende pa e marrë këtë vendim, është zonë e mbrojtur. Po këtu u degradua dhe tani u degradua me kohën që përgjegjësia më së shumti është e njerëzve edhe e bizneseve që kanë operuar atje ilegalisht. Një problem është këtu që Komuna e Rahovecit, të paktën prej kryetarit kur është Smajl Latifi, në mandatin e parë, po edhe këto dy mandate tjera që i pat radhazi, nuk ka marrë asnjë veprim për të cilin e mbron këtë zonë të mbrojtur, që pjesa më e madhe e sipërfaqes është edhe mbrojtur në mënyrë rigorozë, sipas vendimit të vitit 1986. Te madhësia e territorit: sipërfaqja e përgjithshme e zonës së mbrojtur është 198 hektarë, sipas vendimit të vitit 1986, ku 124.9 hektarë janë pjesë e Komunës së Rahovecit. Sipas kërkesës së drejtorit, rekomandimet për reduktimin e zonës së mbrojtur po i bën si propozime të komisionit, të atij komisioni prej ministrisë, po realisht Komuna e Rahovecit ka bërë kërkesë që është pranuar prej ministrisë dhe ka formuar grup punues për rikategorizimin e zonës së mbrojtur. Tani ata po propozojnë që sipërfaqja totale në zone të mbrojtur të jetë 53 hektarë dhe 70 hektarë prej kësaj zone të mbrojtur po largohen prej zonës së mbrojtur, si dhe qëllimin nuk po na e përmend drejtori. Gjithashtu edhe në vendimin që e kemi ne përpara, nuk po përmendet qëllimi i reduktimit të zonës së mbrojtur. Kjo gjendje sjell dyshime. Një pjesë e këtyre pronave janë pronë shoqërore, janë pronë të shtetit, por edhe një pjesë e madhe e këtyre pronave janë pronë private. Pastaj, një problem tjetër që është gjendja, sipas këtij komisioni, pjesa më e madhe e sipërfaqes gjendet në zonën e ngushtë apo zona rigorozë, domethënë 55 hektarë dhe brenda Komunës së Rahovecit llogariten si zonë rigorozë. Domethënë, po përmendet që, dëmtim i madh ka ndodhur nga separacioni, dëmtimi i digës dhe ndërtimi i objekteve afariste. Kanë operuar bizneset pa marrë pëlqime nga organet përgjegjëse, që i bie është Komuna e Rahovecit edhe një problem tjetër që thuhet këtu: është edhe prezenca e konsiderueshme e mbeturinave dhe duhet të merren masat e menjëhershme. Domethënë, komisioni ka rekomanduar komunës që të merren masat të menjëhershme, minimalisht për mbeturinat, ku Komuna e Rahovecit ka dështuar në mirëmbajtjen e kësaj zone të mbrojtur edhe te mbeturinat. Tani është kjo çështje që dua të shtjelloj edhe një herë. Mënyra si po na servohet neve ky vendim, që gjithashtu neve po na sjell dyshime. Dua të pyes drejtorin, pse po reduktohet kjo zonë? Pse 70 hektarë po dalin prej zonës së mbrojtur për të marrë një vendim të ri dhe kur qëllimi është i njëjtë, sikur vendimi i vitit '86, për mbrojtjen e këtij monumenti. Si e mbron ti një monument natyror, kur ti po redukton zonën e mbrojtur? Atëherë, nëse e shohim këtu, pjesa ku po largohet, ku po reduktohen sipërfaqet prej zonës së mbrojtur, janë prej pjesëve kryesisht për skaj të lumit, ku kjo pjesë duhet të jetë të paktën zonë e mbrojtje. Ndoshta pajtohemi te pjesa e Obeliskut që është vënë në pjesën e zonës mbrojtëse, këtu edhe unë pajtohem që duhet të reduktohet ajo pjesë, por jo edhe sipërfaqja që është afër lumit, se ajo është një bukuri natyrore që ne si institucion duhet ta përdorim. Unë pres edhe për anëtarët tjerë të kuvendit. Burim Krasniqi, bëri disa kërkesa, mos të them kozmetike ashtu. Është e dhimbshme forma si po tentohen të largohen 70 hektarë prej zonës së mbrojtur, me qëllim për të ruajtur zonën e mbrojtur. Nëse Komuna e Rahovecit nuk ka mundur 124 hektarë t'i menaxhojë dhe t'i vlerësojë si zonë e mbrojtur, si po doni ju të na dëshmoni neve që me reduktimin deri në 53 hektarë të kësaj zone, mund ta mirëmbani dhe ta menaxhoni, kur as mbeturinat atje nuk janë pastruar. Aq më tepër që komuna ka qenë e paaftë të ndalë funksionimin ilegal të bizneseve në atë pjesë, duke filluar prej separacioneve të Ura e Fshajtë, te bizneset afariste që janë mbi rrugë edhe përfundim rrugës. Për mua është e papranueshme, është e dhimbshme edhe po ju ftoj që këtë vendim mos ta votoni, sepse po i bëjmë dëm Komunës së Rahovecit, ne po e dëmtojmë një monument natyror, një pasuri natyrore që e kemi si komunë. Besoj që ne të gjithë duhet t'i mbrojmë këto. Unë jam për ta reduktuar, por jo afër lumit. Nuk mund ta vlerësosh si zone të mbrojtur pjesën në Gexhë - rruga kryesore që është për Gexhë, aty te Obelisku e pas Obeliskut, teksa me heq, aty ku e kemi sipërfaqen më të bukur - përkaj lumit Drin. Ju ftoj edhe një herë që mos të

mbështetni këtë propozim të ekzekutivit. Është e papranueshme dhe duhet secili prej nesh ta mbajë këtë përgjegjësi dhe mos të lejojë degradimin e zonës së mbrojtur, degradimin e këtij monumenti më të mirë që e kemi.

Burim Krasniqi: Defrim, ndoshta të duket kozmetike, por nuk është ashtu. Nuk e di kur ke qenë te ura ndonjëherë. A e din ku i bie drini? Unë aty jamë rritur, nuk mund të më thuash që po bën diçka kozmetike, sepse në dri të bardhë jam rritur. Drini nuk mbrohet, se drini fillon prej burimit në Radavc e përfundon te liqeni poshtë në Kukës. Nuk mund të shpallet zonë e mbrojtur krejt. Ajo menaxhohet me Ligjin për Menaxhimin e Ujërave, jo me zone të mbrojtur. Aty, një vendim i tillë i ka bllokuar mbi 50 hektarë të një pronari privat, i cili ka pasur projekt me vlerë 6 milionë euro, bashkë me Bankën Botërore dhe me Bashkimin Evropian dhe për shkak të këtij vendimi, projekti nuk është realizuar kurrë. Dokumentat e komunës, që në kohën e privatizimit kanë shkuar në AKP, thonë që është zonë ndërtimore, ndërsa ky vendim thotë që është zonë e mbrojtur dhe kjo është një konflikt dhe janë kontradiktor në mes vete. Si e tillë, nuk mund të preket as shtrati i lumit. Sa i përket digës (branës), ka funksionuar që drini të shkojë përmes kanalit për ujitje nëpër fusha të fshatit. Në momentin që ka hyrë Radoniqi, është mbyllë kanalli dhe është hequr diga, sepse do ta vërshonte gjithë pjesën e Gexhës. Kjo është arsyeja pse ka ekzistuar ajo. Kur të flas, flas për një vend që jam rritur dhe nuk e mbaj në mend se në cilën moshë nuk kam shkuar atje të lahem, jam rritë aty. Para kësaj here e kam kundërshtuar, sepse te pjesa e Gradishit, ka qenë që vetëm një pjesë në mes të zonës së mbrojtur, të hiqet prej zonës së mbrojtur. Unë kam kërkuar që le të jetë në parim për të gjithë përgjatë rrugës, e jo në mes të mesit. Për pjesët nën Urën e Fshajtë, që fillon pjesa ish 1 maji e te poshtë, ajo është e turpshme të jetë zonë e mbrojtur. Ajo e ka bllokuar krejt zhvillimin e asaj zone. Separacione s'ka aty. Një pronar është, një separacion e ke një betonare – Vëllezërit Morina dhe s'ka më separacione. Është fabrika e Ilamarinës dhe nuk ka më tjetër.

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, sipas kësaj harte të propozimit profesional nga Agjencioni i Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit. Kjo harta me të kuqe i ka koordinatat. Do të thotë krejt kjo sipërfaqe në zonë kadastrale, në Xërxë dhe në Gexhë, i ka kufijtë e vet dhe dihet saktësisht cila parcelë, cila zonë mbetet në zonë të mbrojtur. Secila parcelë private i ka kufijtë e vet. Aty ku prona shtetërore ndahet dhe një pjesë e pronës shtetërore hiqet prej zonës së mbrojtur - një pjesë mbetet, aty formohen koordinata të reja dhe me të drejtë këtij dokumenti, para se të çojmë për ligjshmëri edhe kuvendarë, deri të hënën, do ta prezantojmë edhe me një skicë me koordinatat e kësaj harte me ngjyrë të kuqe. Secili kuvendar edhe MAPL-ja do ta ketë, përveç këtyre dokumenteve edhe një hartë me koordinata të zonës së mbrojtur, që është në dy zona kadastrale. Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: ky vendim i kuvendit kur e ka vënë në mbrojtje këtë kanion, është thirrur në ligjet për mbrojtje të natyrës - KSAK, me propozim të entit krahinor për mbrojtjen e natyrës - Prishtinë. Në bazë të statutit të Komunës së Rahovecit, në seancën e përbashkët të Dhomës së Punës së Bashkuar dhe Dhomës së Bashkësive Lokale, para 39 viteve. Këtu, jemi pas 39 viteve dhe ky vendim që janë thirrur këta njerëz, që ti po i vë në dyshim këta 9 njerëz: Sami Behrami - Udhëheqës i Sektorit të Zonave të Mbrojtura, IKMN- kryesues, Nexhmije Kamberi - Zyrtare për Biodiversitet, IKMN- anëtare, Ali Sefa, Zyrtar i Lartë Ligjor, Miradije Gërgoni, u.d Udhëheqëse e Divizionit të Natyrës, DMMU, anëtare, Përparim Gashi, u.d Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit, anëtar. Drejtorë të Komunës së Rahovecit, drejtorë të përfaqësuesve të urbanizmit të Gjakovës, Elez Krasniqi, profesor në Departamentin e Biologjisë, FSHMN, anëtar. Të gjithë këta, bashkë me ministrinë, ministrinë e Defrimit dhe timen, kur e kanë marrë vendimin janë bazuar fatmirësisht me ligje që nuk shkruajnë më KSAK, as ato Dhoma të Bashkuara që kanë qenë, por shkruan Republika e Kosovës. Ata me vendimin kur e kanë formuar me këta anëtarë, e kanë nxjerrë mbas ligjeve të Republikës së Kosovës. E këta profesionistë secili më i mirë se tjetri, bashkë me neve kanë dalë atje në terren katër here, e kanë incizuar gjendjen dhe e kanë paraqitur me letër se çka ka atje, atje, në cilën zonë, në cilën parcelë dhe çka po duam të mbrojmë. A këtu para 39 viteve, edhe në atë kohë kryesia e bashkësisë së Xërxës ka vepruar drejt. Atëkohë, për ta mbrojtur atë territory dhe që disa kolonë të republikave dhe krahinave në nivel të ish-Jugosllavisë, e kanë shpallur zone të mbrojtur dhe e kanë ruajtur. Përndryshe, sot kishit pasur rende me shtëpi atje me kolonë, që na kishin ardhur prej Malit të Zi, prej Kroacisë, prej Bosnjës e Hercegovinës. Qëllimi në atë kohë, i atyre njerëzve që janë ende gjallë edhe sot, fatmirësisht, ka qenë që ta mbrojnë këtë zonë me hektarë që t'ua pamundësojnë njerëzve të politikës qendrore në atë kohë, që t'i biejnë këta kolonët e krahinave, prej këtyre republikave. Kjo tashmë nuk ekziston. Jemi

tridhjetë e nëntë vjet pas dhe më quditë fakti se si ka mundësi një njeri që e do të mirën e kësaj komune që është për zhvillim ekonomik, në të njëjtën seancë të kuvendit, një orë më mban “ders” këtu se si të shkelim ligjin, që ta zgjerojmë zonën ndërtimore për të marrë një lagje atje dhe pas pauzës kërkon nga unë që mos ta lejojmë të zhvillohet ndërtimi dhe zhvillimi ekonomik atje. I njëjti njeri, para dhe pas pauzës. Në një anë na ka mbajtur ligjëratë, si të shkelim ligjin, të zgjerojmë zonën ndërtimore në Bërnjakë, pas pauzës, hajde po thotë ta mbrojmë. Çka të mbrojmë? Të mbrojmë 50 hektarë që ministrat e Defrimit, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, i kanë privatizuar, njëri ka blerë 50 hektarë, i ka privatizuar për të zhvilluar biznes aty, për të punësuar njerëz, për të bërë fabrika aty. AKP-ja e shet me të drejtë, me ligj të Parlamentit të Kosovës e privatizon, ky e blen - e paguan dhe ti nuk ia jep të drejtën të ndërtojë, se është një vendim të kuvendit të komunës të vitit 86’, që është thirrur në disa Dhoma të Bashkuara. Nuk ka mashtrim këtu. Unë s’jam mashtrues, ju mendoni që me 700€ kam ardhur t’ju mashtroj juve?! Ai që nuk më njeh, thotë: “qe ky mashtruesi si nuk i vjen marre”. Nuk është qëllimi i mashtrimit, qëllimi është i zhvillimit ekonomik, të lirohen ato parcelat atje, që janë privatizuar me të drejtë dhe me ligje. Sot e kësaj dite privatizohen pronat, edhe pse është pretenduar ndryshe, të mbyllen. Më 31 dhjetor ka skaduar afati, kur është bërë strategjia, me ia mbyllë dyert AKP-së. Më 31 dhjetor, AKP-ja i ka bërë 250 shitje, me të drejtë, se ne jemi në kapitalizëm. Uroj që të vazhdojë kjo. Është fat i mirë që nuk është mbyllur. Unë po kërkoj prej jush ta votoni vendimin, t’i zhblokoni ato parcelat atje, t’i jepni mundësi zhvillimit ekonomik në ato vende, sepse shumica prej këtyre parcelave atje janë private dhe njerëzit i kanë privatizuar për të zhvilluar biznese aty. Është fati ynë i mirë që ende nuk e kemi përfunduar HZK-në, edhe pse në PZhK është e paraparë si zonë e mbrojtur, gjatë diskutimit publik për HZK, drejtori do të kujdeset që këto zona që lirohet prej Kanionit të Drinit të Bardhë, të parashihen si zona ndërtimore me HZK. Unë e kam një kërkesë ligjore, pas gjithë këtij analizimi profesional, ju ftoj që për hir të qytetarëve dhe të pronarëve, si dhe për zhvillim ekonomik, ta votoni këtë vendim.

Kryetari: Është qudi në këtë kuvend që ka asambleistë që po bëhen me të vërtetë të quditshëm dhe të gërditshëm. Kjo është e saktë. E pavërteta nuk vlen në këtë kuvend. Unë e kam nisur dhe përfunduar projektin “Kompleksi Memorial për Dëshmorët e Kombit”. Në atë kohë i kam fituar 250.000€ grant prej ministrisë. Në mandatin e dytë, e kam bërë një shteg të ecjes dhe ballkonin në Kanionin e Urës së Shenjtë, me ndriçim dhe me ulëse. I kam ndalur disa buldozhera, që deri atëherë nuk i ka ndalur askush, ndërsa unë po. Tjetër, në Gradish është ndërtuar një shtëpi private dhe ne bashkë me inspektorë kemi vepruar. Inspektorët e ministrisë nuk kanë mundur ta ndalojnë, ne ia kemi vendosur shiritat dhe kanë vazhduar dënimet tjera. Unë plotësisht pajtohem me Burimin. Së pari duhet të shkosh ta vizitosh atë zonëm, se dikush kujton që komuna e Rahovecit është veç rreth i lagjes së vet. Betonierka që po përmendet, më duket Burimi ka qenë asambleist kur ka marrë leje prej këtij kuvendi të komunës, për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës. Ju përkujtoj faktin që në këtë kuvend është miratur një version dhe e dini që është kthyer e kundërligjshme, sepse ka skaduar periudha e ekspertizës. Nuk jam i sigurt, por do të kujdeset dikush në procesverbal, që të marrim vesh se si kanë votuar asambleistët, por me gjasë vendimi ka kaluar dhe është kthyer i paligjshëm. Është dashur të kalojë edhe një vit e sa, për të ardhur në shprehje formimi i një komisioni të ri dhe hartimi i një raporti profesional prej ekspertëve. Te dyshimet: gjithçka që nuk i shkon për fytyrë dikujt, për dikë është e dyshimtë dhe kjo është non-sens. Një njeri me këtë moshë që je ti, destinacionin e ke të qartë – je i dështuar në aspektin politik dhe do të dështosh nëse vazhdon të mbash pozicione të standardeve të dyfishta. Është tipik mashtrim dhe është mirë të mos bësh skena dhe improvizime. Jemi në mledhje të kuvendit të komunës dhe jo gjithçka është politikë dhe tek e fundit duhet të kesh vëmendje se çka po deklaron 2 orë para e dy orë pas. Mbeturina në atë zonë nuk ka dhe mos përdor gënjeshtër dhe insinuata. Nëse ndonjëherë bëhen mbeturinat, ne kemi kompani të menaxhimit dhe grumbullimit të mbeturinave. Mos të harrojmë që në atë zonë, në bashkëpunimin me Komunën e Gjakovës e kemi bërë projektin Cross Border dhe urën Tibetane. Sidoqoftë, unë jam pro reduktimit të zonës së mbrojtur, sepse asaj Jogusllavie që është shpërbërë ia kemi kthyer pushkën dhe është e turpshme të thirremi në vendimin e vitit 1986, edhe pse në atë kohë kur është marrë ky vendim, motivacioni ka qenë të parandalohet kolonizimi i asaj treve. Tani, ne po e zvogëlojmë zonën e mbrojtur me qëllim që të mbrohet sipas ligjeve që aktualisht janë në fuqi dhe është tepër e papranueshme që dikush të del këtu, e të thotë që të votojmë kundër. Nuk mundesh ti të bëhesh “strumbullari” dhe t’ia tregosh detyrat atyre që kanë mandate. Ti gjithashtu je me mandat, ose voto-ose jo,

është punë e juaja. Ti nuk je kurrkushi hiç, nuk je politikan, nuk merresh me politikë, je vetëm një asambleist që të respektoj. Kaq është kjo punë! Ti e gjuan gurin dhe e mshefë dorën. Ti je ai që e nxit “Rahovecin n’Fokus” të krijojë klimë të urrejtjes dhe fshihesh, nuk del në ballë e as ai që është pronar i “Rahovecit n’Fokus” të tregojë se kush është. Ta tërheqi vëmendjen që fyerjet, kulifikimet dhe insinuatat, nuk i pranoj, jo vetëm në këtë sallë, por as jashtë kësaj salle. E ftoj kryesuesin, ta respektoj rregulloren dhe mos t’ia jep gjithkujt fjalën, që mundohet në mënyrë të pamëshirshme ta dëshmojë veten që është snob.

Hasan Përboqi: Përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, qytetarë të pranishëm, ju monitorues të kësaj seance. Nëse unë e mora fjalën më shumë dhe tentoj të paktën të jap edhe një kontribut profesional, për arsye se hyn pak, jo pak, por goxha mirë në profesionin tim. E para, disa kushte për të qenë një monument i mbrojtur, monument natyral. Bazohem në këtë propozim. Ky monument natyre i plotëson kushtet për të qenë monument i mbrojtur, me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik. Tek karakteri gjeomorfologjik, ajo është shumë normale dhe i plotëson kushtet. Është diçka që shihet me sy, kanioni i urës së Lumit Drini i Bardhë dhe është ura aty që është monument, deri këtu jemi në rregull, shumë i plotëson kriteret dhe është shumë në rregull që të jetë si monument i mbrojtur. Tek karakteri hidrologjik, të paktën profesioni që unë i takoj e di që asnjë pozicion nuk i plotëson për të qenë karakter hidrologjik. As nuk ka diçka të karakterit hidrologjik të veçantë që të mbrohet, aty është thjesht një lum që kalon, pra nuk i plotëson karakteret e mbrojtjes së monumentit hidrologjik. Ne duam ta zhvillojmë zonën, po ajo zonë nuk zhvillohet duke kufizuar investimet aty. Nëse ajo vazhdon të jetë në këtë sipërfaqe, siç është deri tani prej kohës kur është vënë në mbrojtje, atëherë jemi edhe vetë dëshmitarë që nuk i ka kontribuar zhvillimit të asaj pjese. Pse nuk i ka kontribuar? Sepse është vetë vendimi që e kufizon. Unë jam i mendimit që përtej urës, pjesa poshtë nuk duhet të figurojë në asnjë moment si monument i mbrojtur, për arsye se ajo i ndalon investimet aty. Në momentin që është monumenti i mbrojtur, atëherë vetvetiu ne e ndalojmë çdo lloj investimi, si dhe investimi më i vogël për të ndërtuar shtratin e lumit Drini i Bardhë është i ndaluar. Me këtë që është tani në fuqi, me këtë është i ndaluar të ndërtohet shtrati i lumit Drini i Bardhë. Ajo mundet të mbrohet duke u reduktuar sipërfaqja, duke u dhënë mundësi që të ketë investime aty, por edhe aty duhet të ketë parasysh. Mundet të ngrihet në formën nëse në PZhK, ajo është e lejuar vetëm si zonë turistike, pra të ndërtohet diçka për zhvillimin e turizmit, e jo të mbrohet duke e shpallur një monument natyre, për arsye se nëse është monument natyre, atëherë nuk guxon të lëvizë kushtimisht asnjë “kaci” aty. Si zhvillohet zona nëse ne vetvetiu i ndalojmë vetes që t’i ofrojmë mundësi dikujt të investojë? Duhet të ndalohet, po të ndalohet çdo veprimtari tjetër përpos veprimtarisë turistike që jep një pamje të mirë. Të gjithë jemi dëshmitarë, se çfarë i kemi ofruar këtij monumenti natyre, me këtë sipërfaqe që është tani, çfarë zhvillimi i ka ofruar asaj zone? Asnjë zhvillim, ka mbetur djerrinë një pjesë e tërë dhe nuk ka përparuar sa duhet, e për t’u zhvilluar, mendoj që duhet të reduktohet. Unë jam i mendimit që duhet të reduktohet deri te ura. Përtej urës, çdo gjë të lejohet, por të ketë edhe aty hapësira e kufizuar që të lejohet diçka që i kontribuon zhvillimit të asaj pjese, përveç, përsëri, përveç kanionit dhe urës, asnjë kriter tjetër këtu nuk plotësohet për të qenë monument i mbrojtur hidrologjik, jo se jo, por as gjeomorfologjik. Unë mendoj që kjo zonë duhet të reduktohet, t’i jepet hapësirë asaj toke të zhvillohet dhe normalisht pastaj të kontribuojë edhe zhvillimit të asaj zone.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe të gjithë të pranishëm. Unë, lidhur me temën nuk dua të ndalem se nuk dua ta elaboroj shumë, materialet i kemi përpara dhe dimë se diçka mund të ndërmarrim e të veprojmë. Desha konkretisht lidhur me fjalimin e kryetarit, duhej të bazohej se vetë jam asambleist këtu. Nuk mendoj që edhe në këtë pikë, ndoshta te pika e dytë kemi mundur personalisht të merremi me secilin, por as duhet t’i dalë në mbrojtje Defrimit, por të gjithë asambleistëve siç jemi këtu me këtë retorikë, siç e dëgjuam, se nuk keni të drejtë as të bisedoni andej e këndej. Kryetar, ndoshta ti je më tepër i zgjedhur dhe do të thotë me votën më të madhe, por rastësisht asnjëri nuk është këtu dhe nëse marrim një fjalim për të dëshmuar diçka ose për të faktuar, qoftë e faktuar ose jo, të na lejojnë aq sa dimë, aq sa mundemi, por jo të na kufizoni në diskutime. Veç desha të protestoj këtu, në këtë temë, nuk po dua të ndalem, e kam votën time, pro - kundër ose abstenim, por do të kisha dashur të shoh një kryetar, siç e kam parë deri tani, jo me atë fjalim.

Kryetari: Bejtullah, faleminderit për këshillën! Unë reagoj vetëm kur të ma qet “përmbi kapuç”.

Është hera e sate që ky merret me kualifikime dhe më akuzon drejtpërdrejt. Le të merret vesh edhe me vëllain e vet edhe për atë shkrim, përndryshe ky do të ballafaqohet bashkë me villain me padi. Ky tha që e ka shtkatërruar atë zone të mbrojtur, ndërsa unë i tregova se çka kemi bërë në atë zone. Uroj që këshillëtarët e tillë që kanë pozicione tendencioze dhe që merren me insinuata, të mos votohen kurrë nga qytetarët e Rahovecit. Kjo nuk është gjuhë fyese, por është kundërvlerë e asaj që unë vazhdimisht e dëgjoj prej të njëjtit asambleist.

Ilir Pallqa: Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Qasja e tillë e kryetarit është e gërditshme. Defrimi ka pyetur se cili është qëllimi për reduktimin e pronave që janë në mbrojtje. Ju këtu i përmendët disa qëllime tjera, ndërsa në dokumente kurrëfar qëllime nuk ka. Drejtor, je artist, nuk ka dyshime. Me qenë zone e mbrojtur dhe zonë bujqësore, dallimi është si nata me ditë. Nuk bëhet analogji në këto dy gjëra. Tani je në zor kryetar, rezultati i zgjedhjeve nuk po të pëlqen aq shumë. As mua nuk po më pëlqen rezultati i zgjedhjeve, por juve ju ka humbur pak fokusi. Çka ka këtu për ta përmendur Rahovecin n’Fokus? Unë jam duke e dënuar gjuhën e kryetarit. U përmend një media lokale këtu, që po bën opozitë dhe po e mban në mbikëqyrje. Në këtë aspekt ne duhet ta suportojmë e jo të bëjmë filma. Te kanioni ka mbeturina, sepse kam qenë aty dhe prapa te Kramoviku. Kemi shëtitë edhe ne, se Rahoveci është vend i vogël dhe krejt çka ka thënë Defrimi qëndron. Ka lënë hapësirë për dyshim dhe ndoshta është mirë që anës drinit mos të ketë ndërtim. Është e thjeshtë, përgjigjuni pa kualifikime, kaq!

Kryetari: Vazhdoj ta përsëris faktin që asambleisti në fjalë vazhdon të jetë një politikan i çoroditur dhe i gërditshëm. Do ta mbaj këtë qëndrim derisa nuk reflekton ky vetë, sepse vazhdimisht akuzon dhe përdorë insinuata. Kjo nuk ka lidhje as me zgjedhje, as me asgjë. Nuk mundet dikush të pretendojë që t’ia tregojë të gjitha detyrat dikujt tjetër. Unë nuk ia tregoj detyrat kërkujt, sepse jemi në kuvend të komunës. Nëse dikush e merr guximin që ndaj kryetarit të komunës të sillet në mënyrë idiotike, çka po pritni ju? A po pritni të jem si struci dhe ta fus kokën në zallë? Kurrë!

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Sa e mbaj në mend unë, kjo pikë e rendit të ditës ka qenë edhe në 2017-tën dhe kemi diskutuar, mirëpo, përshkak që kanë qenë zgjedhjet afër dhe që mos të ketë konotacion politik, e patëm kaluar më duket dhe për atë arsye kjo temë ka mbetur për trajtim deri tani. Këtu në vendim shkruan: vendim për vënien nën mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë, në kategorinë: monument i natyrës në komunën e Rahovecit. Ndoshta më mire si titull do të ishte: ripërkufizimi i kanionit, ridefinim i kufijve ose zvogëlim i sipërfaqes për qëllime të caktuara në interes të qytetarëve dhe të zhvillimit të bizneseve. Ne si anëtarë të kuvendit e dimë qartë që jemi pro mbrojtjes së interesave të qytetarëve dhe zhvillimi ekonomik nuk mund të ndodhë nëse ne i ngulfatim qytetarët me vendime të caktuara, që i kufitojnë në të drejta për të ndërtuar diçka. Vërejtja ime ishte te definimi i vendimit dhe ndoshta do të ishte më mirë të shkruhet: rikonfigurim ose ridefinim i kufijve. Jam pro dhe unë do ta votoj këtë pikë të rendit të ditës, sepse jam për zhvillimin ekonomik të vendit.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, pas diskutimeve të shumta, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 16 vota “për”, asnjë kundër dhe një abstenim, votohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale, 01 Nr. 80/20 e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21, të datës 26.2.2021 dhe Rregulloren 01 Nr. 22/23 të datës 28.2.2023:

Kryetari: Faleminderit! Ne e kemi një plotësim-ndryshim të rregullores për taksa komunale me Nr. 80/20 e datës 29.6.2020. Propozojmë që nga taksat e shërbimet shëndetësore t’i lirojmë punëtorët e zjarrfikësve, të ekoregjonit dhe besoni që këto ditë më janë kujtuar edhe policia, FSK-ja dhe TMK-ja (ata që janë në pension). Nëse jeni dakord, unë ju ftoj ta votoni.

Lirigzon Kastrati: Edhe unë mendoj si kryetari, doja të propozoja për FSK-në dhe policinë.

Kryesuesi: Nëse nuk keni diskutime tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit 01-Nr. 280/24 të datës 26.12.2024:

Afrim Oruqi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, e kemi plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. protokol 01 Nr.280/24 i datës 26.12.2024. Në takim me komision e kemi pa të arsyeshme që ta plotësojmë dhe ndryshojmë vendimin, sepse në vendim nuk e kemi paraparë çmim. Çmimin, edhe pse e kemi përmendur që përcaktohet me rregulloren për taksa dhe tarifa, mirëpo, sipas praktikës për të njëjtat parcela në zonën e njëjtë ka dështuar dy herë ankandi publik, sepse del të jetë shtrenjtë me 5 centë për m² për muaj. Ne kërkojmë nga ju që ta plotësoni dhe ndryshoni këtë vendim, që përmes ankandit publik t'i japim me qera këto 2 ha e 50 ari. Përveç kësaj, e kemi paraparë një paragraf që pagesa për muaj do të filloj pas 24 muajve. Ju propozojmë juve 2.5 centë për m² për muaj (625€) dhe një afat për 24 muaj, deri sa të fillojë veprimtarinë biznesi. Qëllimi: ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike dhe zhvillimi i turizmit-rekreacionit. Kërkojmë nga ju që ta amandamentoni vendimin bazë, ta plotësoni dhe ndryshoni.

Ilir Pallqa: M'u duk si liqen hijezimi aty në hartë! Drejtori e përmendi çështjen e zhvillimit. Është mirë t'i bëni disa gropa dhe mbushet Rahoveci, se ka "bajagi" rrjedhje.

Kryesuesi: Nëse nuk keni diskutime tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e pestë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot.01 Nr. 181/24 i datës 30.01.2024, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit:

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Pas largimit të dy anëtarëve që kanë qenë pjesë përbërëse e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, në seancën e kaluar është formuar komisioni për përzgjedhjen e dy anëtarëve të rinj. Pjesë përbërëse e komisionit kanë qenë: Florida Bajraktari (AAK), Merisa Sharku (LVV), Lirigzon Kastrati (LDK), Besmire Bytyqi nga ekzekutivi dhe Vjollca Gurgule (SLH Kosova). Pas shpalljes së konkursit në ueb-faqe të komunës, ka pasur interesim për këtë komitet. Më datë 26 shkurt kemi mbajtur takim dhe i kemi hapur dosjen e 5 aplikantëve: Nashide Shehu, Ferat Durguti, Adelina Vuqitërna, Esra Spahiu dhe Nehat Duraku. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, janë përzgjedhur dy kandidatë: Nashide Shehu dhe Ferat Durguti.

Kryesuesi: Faleminderit Merisë! Nëse nuk keni diskutime tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e gjashtë.

7. Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike:

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë, kjo është pika shtesë dhe veçse është prezentuar nga drejtori Afrim Oruqi. E vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e shtatë.

8. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, 2024/2025:

Avni Morina: Mirëditë të gjithëve! Përshëndetje kryesues, nënkryetar, asamblesitë, drejtorë. Në këtë informatë janë të gjitha të dhënat: punët, përkushtimet, angazhimet, problemet apo vështirësitë që i kemi pasur gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, 2 shtator-24 dhjetor 2024. I kam shtuar edhe disa çështje tjera që janë kërkuar nga mbledhja e KPF-së.

Lirigzon Kastrati: Informatën e drejtorit të DKA-së e kam lexuar dhe është më e kompletuar. Informata tregon gjendjen reale të arsimit në komunën tonë. Në vazhdimësi jemi të interesuar që ta përmirësojmë cilësinë e arsimit, andaj sipas raportit në fjalë, mbetet shqetësuese numri i mungesave të mësimdhënësve në orët mësimore dhe numri enorm i mungesave të nxënësve në proces mësimor. Për mësimdhënësit shihet se janë marrë masa për ndalje proporcionale të pagës. Unë mendoj që komuna konform udhëzimit administrativ duhet të shqiptojë edhe masa të tjera. Konsideroj që duhet të punohet edhe për zvogëlimin e mungesave të nxënësve, duhet bashkëpunuar me prindërit. I mbetet komunës që për secilën shkollë të jep udhëzime dhe detyra specifike, duke mirëadministruar procesin mësimor.

Vlora Vuqitërna – Çmega: Në shkollën "Isa Boletini" nuk ka ende kamera. A keni ndonjë plan rreth kësaj?

Defrim Kafexhiu: Informatën nuk e kam shfletuar, sepse ka ardhur pak me vonesë. Nuk e di a e keni përfshirë çështjen e mungesës së kuadrove dhe nëse nuk e keni cekur, nëse keni mundësi përafërsisht të na tregoni se ku kemi mungesa më të mëdha të kuadrove në mësimdhënie?

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin për këtë informatë, për gjysmëvjetorin e parë shkollor. Kemi pasur reagime nëpër shkolla që kanë munguar mjetet (pajisjet) për shumëzimin e testeve. Si është gjendja tani në këtë aspekt?

Avni Morina: Faleminderit për pyetje! Për çështjen e kamerave, në fakt shkolla "Isa Boletini" ka pasur kamera, por ka ndodhur një prishje të sistemit të kamerave në njërin objekt. Jemi në prag të lidhjes së kontratës së re për tre objekte arsimore që na mungojnë kamerat dhe më pas edhe ai objekt që është pa sistem të kamerave do të pajiset me kamera. Objekti shkollor "Bajram Curri" në Krushë të Madhe ende nuk ka kamera dhe shkolla "4 Dëshmorët" në Ratkoc. Te mungesa e kuadrove, e kam theksuar edhe në raport që vërtetë në lëndën e matematikës kemi mungesë kuadro. Në mungesë të tyre duhet t'i marrim me lëndë të përafërta, sepse në shkollën "Xhelal Hajda" dy herë e kemi rishpall konkursin, puna që nuk ka pasur kuadro adekuatë. Numri i mungesave të paarsyeshme që e kam pasqyruar në informatë, kryesisht është për shkak të mungesës së kuadrove specifike. Te mungesa e fotokopjuesve, po, është e vërtetë që kemi mungesë. E kemi angazhuar zyrtarin për IT, i cili po vazhdon t'i evidentojë nevojat e shkollave për këtë mungesë të fotokopjuesve dhe pas marrjes së raportit, do të fillojmë furnizimin me fotokopjues.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse dikush tjetër nuk ka diçka, po e përfundojmë mbledhjen e dytë të rregullt të kuvendit. Ju falënderoj për vëmendje.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi



KRYESUESI


Arbër Zenuni